



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1367/1 prot.

Tiranë, më 04. 12. 2025

V E N D I M

Nr. 290, datë 04. 12. 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 246, datë 24.10.2025, të paraqitur nga shtetasja Z. L. kundër Drejtorisë së shkollës “Andon Zako Çajupi” Tiranë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *ngjyrës, gjuhës dhe gjendjes shëndetësore*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “...*prej 32 vitesh punoj si mësuese matematike dhe prej 11 vitesh në gjimnazin “A. Z. Çajupi” Tiranë. Po ju drejtohem për të paraqitur një ankesë lidhur me diskriminimin dhe trajtimin e padrejtë që më është bërë nga kolegë dhe drejtues të institucionit ku punoj.*”

Jam vënë në shënjestër të shpifjeve, thashethemeve dhe trajtimeve fyese, për arsye që lidhen me:

- *originën time dhe dialektin që flas,*
- *ngjyrën e lëkurës,*
- *gjendjen time shëndetësore (vuaj nga migrena, çka më detyron të mbaj kapele në mot të ftohtë),*
- *mënyrën e të folurit dhe të shprehurit.*

Këto sjellje diskriminuese kanë krijuar një mjedis armiqësor dhe presion të vazhdueshëm ndaj meje, duke më izoluar nga kolektivi dhe duke tentuar të më largojnë nga puna, pavarësisht përkushtimit tim profesional ndër vite. Ky trajtim ka ndikuar ndjeshëm në mirëqenien time psikologjike dhe më ka ulur motivimin për punë.

Si një mësuese me përvojë të gjatë dhe e përkushtuar ndaj nxënësve, ndihem e lënduar dhe e pambrojtur përballë këtij diskriminimi të hapur. E vetmja forcë që më mban të mos dorëzohem janë dy vajzat e mia, për të cilat mbaj përgjegjësi të plotë, pasi jam e divorcuar, si dhe dashuria për profesionin dhe nxënësit e mi...”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit për shkak të *ngjyrës, gjuhës dhe gjendjes shëndetësore*, nga ana e Drejtorisë së shkollës “Andon Zako Çajupi”.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkaqet e pretenduara të diskriminimit dhe lidhjes së tyre, me trajtimin më pak të favorshëm.

Për këtë arsye, me e-mail-et datë 03.11.2025 dhe datë 17.11.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga subjekti ankues informacionin dhe dokumentacionin si më poshtë:

- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkaqet e pretenduara për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë mbartjen e shkaqeve të pretenduara. Pra, duhen shpjeguar shkaqet e diskriminimit dhe si provohen ato?
- Lidhur me pretendimin e diskriminimit për çdo shkak tjetër, duhet sqaruar nga ana juaj, cila është veçantia apo cilësia juaj e veçantë që mund të përfshihet tek çdo shkak tjetër, që ka ndikuar në trajtimin e diskriminues të pretenduar nga ana juaj. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju e mbartni këtë shkak të pretenduar.
- Përveç përshtimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshtkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.
- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek drejtuesit apo në institucione të tjera? Nëse po, na vini në dispozicion një kopje të kërkesave dhe përgjigjeve të marra.

Në plotësim të informacionit të kërkuar më lartë, ankuesja përmes e-mail-it datë 17.11.2025, ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: “...1. Sqarime mbi shkaqet e pretenduara të diskriminimit:

Në rastin tim, diskriminimi është shfaqur kryesisht në forma të heshtura dhe përjashtuese, të cilat nuk shoqërohen me komunikim të drejtpërdrejtë apo të dokumentuar, por reflektohen në

mënyrën se si jam trajtuar në mënyrë të vazhdueshme brenda institucionit. Këto forma diskriminimi lidhen me veçoritë e mia personale (ngjyrën, gjuhën dhe gjendjen shëndetësore), të cilat kanë ndikuar në mënyrën e mënjanimit tim.

Edhe pse nuk ka prova të drejtpërdrejta të deklaruar apo të shkruara, sjelljet përjashtuese janë të përsëritura dhe të dukshme në mjedisin shkollor.

2. Lidhja e këtyre veçorive me trajtimin diskriminues; Diskriminimi i përshkruar është manifestuar në këto forma:

- Nuk jam përfshirë dhe as zgjedhur në asnjë organ të shkollës, ndonëse kam vite përvojë dhe angazhim aktiv në institucion.
- Edhe pse jam mentore edhe mësuesja e matematikës me përvojën më të gjatë në shkollë, praktikantët nuk më janë caktuar. Të gjithë mësuesit e tjerë të matematikës në shkollë janë emëruar pas meje, por praktikantët u janë caktuar vetëm atyre.
- Këto raste të mospërfshirjes dhe mënjanimit të qëndrueshëm më kanë bërë të përjetoj një trajtim të pabarabartë të cilin e konsideroj të lidhur me veçoritë e mia personale. Theksoj se diskriminimi i heshtur shpesh manifestohet në forma të tilla tërthore dhe të vazhdueshme, që e bëjnë të vështirë dokumentimin klasik përmes provave të drejtpërdrejta.

...

4. Informacion mbi ankesat e mëparshme:

Nuk kam paraqitur më herët një ankesë formale lidhur me trajtimin diskriminues, pasi natyra e tij ka qenë e heshtur, e tërthortë dhe jo e dokumentuar. Megjithatë, dokumentet e bashkëngjitura tregojnë qartë qëndrimet institucionale të drejtores së shkollës ndaj meje...”.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të

personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Në ankesën e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është pretenduar se trajtimi i saj i padrejtë apo i pafavorshëm nga Drejtoria e shkollës “A. Z. Çajupi”, ka ardhur për shkak të ngjyrës, gjuhës dhe gjendjes shëndetësore.

Së pari, dokumentimi i shkaqeve për të cilat pretendohet diskriminimi është thelbësor në çështjen e provimit të tij, për të cilin ankuesja pretendon se ka ardhur si pasojë e posedimit të tyre.

Së dyti, pasi ankuesja të ketë provuar se mbart shkaqet e pretenduara, duhet që të sjellë indicie, fakte apo prova që të dokumentojë, se pikërisht bazuar në këto shkaqe (ngjyra, gjuha dhe gjendja shëndetësore), ajo është trajtuar në mënyrë të pabarabartë e të pafavorshme nga ana e Drejtorisë së shkollës “A. Z. Çajupi”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të ngjyrës, gjuhës dhe gjendjes shëndetësore, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon një shkak të mbrojtur, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkakun e pretenduar, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë ngjyra, gjuha dhe gjendja shëndetësore e ankuses. Lidhur me dokumentimin e shkaqeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga subjekti ankues, fakte dhe prova për të provuar ato.

Nga informacioni i sipërcituar, ankuesja nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit fakte dhe prova sa i përket shkaqeve të pretenduara prej saj. Megjithatë, pretendimet e ankuses sa i përket shkaqeve lidhen me:

- *shkaku i ngjyrës*, ka referuar ngjyrën e lëkurës së saj, por si informacion i thënë në mënyrë të përgjithshme dhe pa specifikuar ndonjë karakteristikë të veçantë në lidhje me këtë;

- *shkaku i gjuhës*, duke referuar prejardhjen nga Vlora por pa e lidhur atë me ndonjë situatë të veçantë që mund të lidhet me dialektin;
- me dialektin;
- *shkaku i gjendjes shëndetësore*, me faktin që ajo vuan nga migrena çka e detyron atë të mbaj kapele në mot të ftohtë).

Dokumentimi i një karakteristike individuale është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas, të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se trajtimi i pabarabartë, i pafavorshëm apo i paligjshëm i pretenduar nga subjekti ankues lidhen pikërisht me një karakteristikë individuale.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkaku i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Në rastin konkret, pala ankuese nuk parashtroi fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të Drejtorisë së shkollës “A. Z. Çajupi”, që të jenë motivuar apo nxitur nga shkaqet e pretenduara prej saj.

Gjithashtu, nga ana e ankuses është referuar një “Rekomandim”, i lëshuar nga Drejtoria e shkollës “A. Z. Çajupi”, i cili mban datën 06.11.2024, ku citohet ndër të tjera se: “Është kënaqësi t’ju rekomandoj Z. L. si një mësuese shumë të mirë dhe një bashkëpunëtoare e shkëlqyer dhe me aftësi në drejtim. Unë kam patur kënaqësinë të punoj bashkë me të, në të njëjtën shkollë prej një periudhe

kohore prej tre vitesh, dhe mund të them se ajo është një mësuese dhe kolege e përkushtuar dhe e dedikuar në mësimdhënie e shumë bashkëpunuese.

Gjithmonë në punën e saj, Z. L. është e qëndrueshme, e pasionuar dhe është një kënaqësi të punosh me të pasi është e aftë për punët organizative dhe për të punuar në grup.

Unë si drejtuese e shkollës “Andon Zako Çajupi” rekomandoj pranimin e saj në Institucionin tuaj, sepse jam e sigurt që me kapacitetin e saj arrin të komplotojë çdo detyrë me sukses...”.

Në këtë kuptim, ankuesja nuk vuri në dispozicion të Komisionerit prova dhe fakte sa i përket veprimeve apo mosveprimeve të Drejtorisë së shkollës “A. Z. Çajupi”, përmes të cilave mund të prezumohet se ato janë motivuar apo nxitur nga shkaqet e pretenduara prej saj.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson, se ankuesi nuk ka dhënë informacion për të shpjeguar dhe dokumentuar, se si kanë ndikuar shkaqet e pretenduara në trajtimin e pafavorshëm të tij, në kuptim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar¹.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj..

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 246, datë 24.10.2025, të subjektit ankues, Z. L., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

¹ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Ngjyra, gjuha dhe gjendja shëndetësore)
(Fusha: Punësim)